



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.540/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gresa Baraliut kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prizren, paraqitur për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Gresa Baraliut kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Prizren, paraqitur për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.10.2014, nga Gresa Baraliu kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve me datën 22 tetor në katër venvotime janë tjetërsuar votat pasi që pas numërimit të votave në FPR në dyert e klasave mungojnë votat e familjareve dhe miqve të cilat janë tjetërsuar në FPR. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rinumërohen votat në këto vendvotime: 2022A në shkollën fillore Heronjt e Lumës, 2006A në shkollën fillore Fadil Hisari, 2007A në shkollën fillore Lek Dukagjini, 2027A në shkollën fillore Idriz Seferi.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimet 2022A, 2006A, 2007A, 2027A, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesës. Hudhja e ankesës së Gresa Baraliut, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesës nuk i mohohet

e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.540/2017 më datën 31.10.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.